



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 37
Prishtinë, më 14.12. 2009 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Arsim Rexhepi, Donika Kadaj - Bujupi, Enis Kervan dhe Dragan Dimiq.

Munguan: Mark Krasniqi, Heset Cakolli dhe Memli Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi i OSBE - së, i NDI - së, përfaqësuesi nga Presidenca dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi: Agim Veliu, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1 . Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës,**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Agim Veliu, kryetar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1 . Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 25.11.2009.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës.

Kryesuesi lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia dha raportueses së Komisionit, Drita Kadriu.

Drita Kadriu - tha se e ka shqyrtuar nen për nen Projektligjin për Mërgatën duke u bazuar edhe në sugjerimet që janë dhënë gjatë leximit të parë në Kuvend dhe para Komisionit e ka paraqitur amendamentimin e tij. Gjatë amendamentimit të Projektligjit ka pasur paqartësi lidhur me titullin e Projektligjit, që emërtimi i tij të jetë “për mërgatën” ose “për diasporën”. Ajo mendon se është e pamundur që me një ligj të rregullohen të gjitha konceptet historike dhe politike të nocionit në fjalë dhe ka ardhur në përfundim që titulli të mbetet si në Projektligj. Tha se është dëshirë dhe vullnet i madh të rregullohen të gjitha çështjet e qytetarëve, që jetojnë jashtë trojeve të Kosovës. Për këtë arsye vlerësoi që më parë të mbahet një dëgjim publik lidhur me Projektligjin për Mërgatën e Kosovës. Njëkohësisht propozoi që në këtë takim të ftohen faktorë relevantë brenda dhe jashtë Kosovës, që mund t'i ofrojnë opinionet e tyre, të cilat do t'i kontribuojnë Komisionit gjatë amendamentimit të tij.

Arsim Rexhepi – theksoi se duhet të mbahet një dëgjim publik lidhur me Projektligjin për Mërgatën e Kosovës, sepse ky ligj është i një rëndësie të veçantë dhe pohoi se Mërgatën e Kosovës e përbëjnë 90% qytetarët shqiptarë nga Kosova.

Ai propozoi të ftohen të gjitha shoqatat e shqiptarëve që jetojnë e punojnë në botën e jashtme, siç janë Shoqata e Gorarëve në Kosovë, Shoqata e Shqiptarëve që jetojnë në Turqi, etj. dhe përfaqësues të komuniteteve tjera. Më pas shtoi se duhet të vihen kontakte me Zyrën për Çështje Jorezidente që do ta ofrojnë listën e cilësisë së ekspertëve, që do t'i ftojme në këtë seancë dëgjimore.

Enis Kervan – tha se ka vërejtje në Projektligjin për Mërgatën e Kosovës, lidhur me nenin 3. i cili flet për përkufizim të pjesëtarëve të Mërgatës së Kosovës dhe ceku se në kuadër të këtij neni është edhe Ligji për shtetësinë. Ky ligj mbështet vetëm pjesëtarët e diasporës e jo edhe të mërgatës, andaj konsideron se nuk ka nevojë që çdo person të ketë përkufizime që të jetë pjesë e diasporës. Kjo problematikë është e njëjtë edhe me titullin e Projektligjit për Mërgatën, andaj propozoi që këto çështje të rishqyrtohen gjatë amendamentimit të tij. U pajtua me parafolësit që të mbahej seanca dëgjimore dhe propozoi të ftohen përfaqësues të disa ambasadave, zyrat e të cilëve janë në Kosovë p.sh. të Gjermanisë, të Turqisë etj. dhe njëkohësisht të kontaktojmë me zyrtarë të MKRS -së.

Agim Veliu, kryetar - tha se para se të fillojmë me shqyrtimin e amendamentimit të Projektligjit për Mërgatën e Kosovës, Komisioni ishte i pajtimit të mbahet një dëgjim publik më 28. 12. 2009 në orën 11: 00, në sallën C-301, ku do të ftohen përfaqësues të shoqatave të qytetarëve që përkohësisht jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme, si dhe përfaqësues të institucioneve që kanë të bëjnë me këtë problematikë.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11:30

Kryetari i Komisionit

Agim Veliu